



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ prot.

Korçë, më _____.

RELACION

Për

Rishqyrtimin dhe lënien në fuqi të VKB-së, nr. 57, datë, 25.04.2024, “Mbi miratimin e ndihmës financiare për Zonjën Albina Matraku, për dëmet e shkaktuara në banesë nga rënia e zjarrit.

Bazuar në nenin 30, gërma “gj”, dhe nenin 41, (pika 2), të Ligjit, 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, dhe VKM-në, nr. 329, datë, 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kapitulli i III-të, pika 1, gërma b, Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e datës, 25.04.2024, aprovoi ndihmën financiare për familjen e Znj. Albina Matraku, të prekur nga rënia e zjarrit në banesën e saj në datën, 02.03.2024.

Prefektura e Qarkut Korçë, me shkresën nr.nr. 396/1, datë, 07.05.2024, “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit”, e protokolluar në Bashkinë Korçë, me nr. Protokolli, nr.3562/1, datë, 08.05.2024, nuk konfirmon vendimin nr. 57, datë, 25.04.2024, të Këshillit të Bashkisë, “Mbi miratimin e ndihmës financiare znj. Albina Matraku, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e saj”, me arsyetimin se, “Gjatë verifikimit të anës formale të aktit rezultoi se akti është i paplotë duke mospërmbushur elementët e cituar në kreun III, **pika 1**, gërma “a”, “b”, **pika 2**, gërma “a”, “ç”, “dh”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Referuar VKM-së, nr. 329, datë, 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, për pikat e shënuara në shkresën nr. 396/1, datë, 07.05.2024, “Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit”, e ardhur nga Prefektura Korçë, nuk kanë bazueshmëri ligjore dhe sqarimi citohet si më poshtë vijon:

- I. Nuk përmbush elementët e cituar në Kreun 3, pika 1, gërma “a”, “b”, të VKB-së, nr. 329, datë 16.05.2012.
 - Për gërmën “a”, të Kreut 3, të VKM-së, 329, datë 16.05.2012, nuk qëndron sepse, familja e znj. Albina Matraku ka paraqitur kërkesë me shkrim pranë Rajonit nr. 3, dhe 1(një), kopje është në dosjen pranë Sektorit të Emergjencave Bashkia Korçë.

- Për germën “b”, të Kreut 3, të VKM-së, 329, datë 16.05.2012, nuk qëndron sepse, me urdhër të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni i konstatimit dhe ka kryer verifikimin në banesë për dëmet e shkaktuara nga zjarri.
- II.** Nuk përmbush elementët e cituar në Kreun 3, pika 2, gërma “a”, “ç” dhe “dh”, tëVKB-së,nr. 329, datë 16.05.2012 .
- Për germën “a”, të Kreut 3, nuk qëndron dhe sqarimi është i njëjtë me pikën e dytë të paragrafit të I-rë, pra është pregatitur Proceccverbali i kontatimit të gjëndjes.
 - Për germën “ç”, të Kreut të 3, pika 2, nuk qëndron sepse, në dosjen e administruar nga Bashkia Korçë, egziton Çertifikata familjare në momentin e fatkeqësisë.
 - Për germën “dh”, të Kreut të 3, pika 2,nuk qëndron sepse, Akt –ekspertiza e PMNZSH-së, është e plotë, e saktë dhe e dokumentuar në dosje.

Përsa më sipër dhe bazuar dhe në nenin 30, dhe 41, të Ligjit nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, nenit 16, pika 2/b, të Ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, dhe të nenit 54, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë lënien në fuqi të VKB-së, nr.57, datë 25.04.2024, “Mbi miratimin e e ndihmës financiare znj. Albina Matraku, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në në banesën e saj”.

Përgj. Sek. të Em.Civile

Arjan Qasolli

Drejtoria e Përgjith. Financës, Buxhetit dhe M.F.K

Valbona Ziko

Në mungesë dhe me urdhër

Nëpunës Zbatues i Deleguar

Përgjegjëse e Buxhetit dhe MFK

Denada Tabaku

Drejtoria e Përgjith. Juridike

dhe Burimeve Njerëzore

Anxhela (Dishnica)Qeramixhi

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË



Nr. _____ prot.

Korçë, më ____ . ____ . ____

PROJEKT/ VENDIM

Nr. _____ datë, _____ 2024

MBI

“MIRATIMIN E LËNIEN NË FUQI TË VKB-së, NR. 57, DATË, 25.04.2024, “ PËR PËRCAKTIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR ZONJËN ALBINA MATRAKU, PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA ZJARRI NË BANESËN E SAJ”.

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, bazuar në dispozitat e Kreut të III-të, të VKM-së, nr. 329, datë, 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, nenit 30, dhe 41, të Ligjit nr. 45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, të nenit 16, pika 2/b, të Ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, dhe të nenit 54, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Korçë:

VENDOSI

1. Lënien në fuqi të VKB-së, nr. 57, datë, 25.04.2024, “Mbi miratimin e ndihmës financiare znj. Albina Matraku, për dëmet e shkaktuara nga zjarri në banesën e saj”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MKF, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit, 55, pika 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me _____ vota

Vota pro _____

Vota kundër _____

Vota Absteni _____

Zbardhur më datë _____

KRYETAR

Ana VERUSHI